

## Kurs i gjuhës frenge për udhëzuesit malor të Republikës së Maqedonisë

### Fleta e kandidaturës

Kandidaturat do të shqyrtohen nga komiteti përzgjedhës, i cili përbëhet nga një përfaqësues nga Ambasada e Francës, një përfaqësues nga Aleanca Franceze në Tetovë, një përfaqësues nga Shoqata e Udhëzuesve Malor të Maqedonisë dhe një përfaqësues nga CRET-i.

### Konteksti

Franca dhe vendet frankofone janë një burim i rëndësishëm klientele alpinistësh (veçanërisht Franca me rreth 6 milion alpinistë), potencialisht të interesuar për destinacionin Maqedoni.

Ndërmjetësues mes vendit dhe vizituesit, udhëzuesi malor është një element i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit malor. Mirëpo, asnjë udhëzues maqedonas nuk flet frëngjisht, gjë që detyron praninë e një përkthyesi dhe në këtë mënyrë rritet çmimi i alpinizmit. Një udhëzues frankofon do të kishte më shumë mundësi angazhimi dhe do të paguheshte më mirë.

### Qëllimi pedagojik

Niveli i kursit iu destinohet **fillestarëve** në gjuhën frënge. Grupi do të përbëhet detyrimisht nga 5 udhëzues.

Në fund të trajnimit, kandidatët duhet të jenë në gjendje të bëjnë bisedë të thjeshtë në gjuhën frënge, të mundën t'u japin informata specifike (informata praktike, biseda tjera gjatë ekskurzionit dhe siguri) grupeve turistike.

### Organizimi i kursit

Kursi përbëhet nga dy pjesë :

1. Një sesion kursi intensiv prej një muaji (15 tetor - 15 nëntor 2012)
2. Një sesion kursi ekstenziv prej 20 javësh (janar – qershor 2013)

Kandidatët do të mësojnë nocione të frengjishtes standarde dhe frengjishtes së specializuar në turizëm malor.

#### *Kursi intensiv*

Ky sesion do të organizohet në periudhë prej 4 javësh, 5 ditë në javë, 6 orë në ditë, ose gjithsej 120 orë.

Orari : 9h – 12h dhe 14h - 17h. Parashihet mundësia edhe për mbajtje të mësimit në teren (për t'u konfirmuar)

#### *Kursi ekstenziv*

Ky sesion duhet t'iu mundësoj kandidatëve t'i ruajnë njohuritë e marra dhe të vazhdojnë të perfeksionohen.

Orari : 2 orë në javë, 1 x 2h ose 2 x 1h. (orari i kursit duhet të përshtatet me orarin e punës së kandidatëve sidomos në sezonin dimëror)

## **Finansimi**

**Vërejtje: Vetëm shpenzimet e kursit mbulohen nga Ambasada e Francës. Asnjë shpenzim tjetër (si transporti, banimi, etj) nuk merret përsipër.**

## **Kandidaturat**

Kandidati duhet t'i sjellë dokumentet vijuese :

- Diplomë për udhëzues
- CV me të dhëna të detajuara mbi përvojën profesionale si udhëzues
- Letër motivimi
- Angazhim për të ndjekur kursin deri në fund : në rast se e ndërpreni kursin, kandidati do të duhet të kthejë çmimin e trajnimit (250 euro për fazën intensive dhe 80 euro për fazën ekstensive). *Teksti i angazhimit është më poshtë; ai duhet rishkruar me dorë.*

*Teksti i angazhimit i cili duhet shkruar me dorë dhe nënshkruar*

Unë i poshtnënshkruari (emri, mbiemri), me vendbanim në (adresa), lindur më (data e lindjes), në (vendi i lindjes), pranoj të ndjekë deri në fund kursin e gjuhës frënge, për të cilin paraqitem si kandidat këtë ditë, ashtu si që është shpjeguar në rregulloren e aplikimit ngjitur këtu, dhe i cili përbëhet nga një sesion intenziv prej një muaji dhe një session ekstenziv prej 20 javësh. Në rast se heq dorë nga ndjekja e kursit (me përjashtim të rasteve shëndetësore të cilët duhen vërtetuar me vërtetim mjekësor dhe që detyrojnë ndërprerjen e punës për më shumë se 5 ditë për sesionin intenziv dhe për më shumë se 20 ditë për sesionin ekstenziv), angazhohem t'ia kthej Aleancës Franceze në Tetovë çmimin e kursit (250 euro për fazën intensive dhe 80 euro për fazën ekstenzive).

Bërë në (vendi), më (data)

Shërben për çdo lloj procedurë ligjore

(mbiemri dhe nënshkrimi)